



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, nenit 20 paragrafi 3 pika 3.3 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenit 9,17,20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, në mbledhjen e vet të mbajtur me 29. 07. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoj këtë:

VENDIM

**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE E KK LIPJAN,
KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR NËDRTIMIN E XHAMISË NË
FSHATIN BAJICË**

Neni 1

Me këtë vendim ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh toka-Pasuri Shoqërore e KK Lipjan Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan me sipërfaqe prej 374m² (3 ari e shtatëdhjetë e katër metra) për ndërtimin e xhamisë për nevojat e banorëve në fshatin Bajicë, nga pjesa e parcelës kadastrale P-71409004-00473-0 në vendin e quajtur "Osmonica smonica" me kulturë varreza me sipërfaqe të përgjithshme prej 12316 m² e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.4199/16 ZK Bajicë, Pasuri shoqërore e KK Lipjan.

Neni 2

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit të parcelës 473-0 me sipërfaqe prej 374m² me kulturë xhami shfrytëzues Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan siq përcaktohet në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

15Nr. 464-41384

Lipjan me 01. 08. 2016

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesja
Vlora Limani-Hajnuni

